Washington State Department of Social & Health Services

PLANI I DETYRAVE INDIVIDUALE (IRP)
INDIVIDUAL RESPONSIBILITY PLAN (IRP)

Plani i detyrave individuale WorkFirst për

_____

JAS ID
CASE NUMBER
CLIENT ID

E kuptoj se:

- Kërkohet që unë të punoj, të kërkoj punë, ose të përgatitem për të punuar me kohë të plotë për të paktën 32 orë në javë.
- Unë duhet të kryej aktivitetet e kërkuara. Në rast se nuk e bëj këtë, do të më vihet gjobë po qe se nuk vërtetoj se kam pasur arsye të fortë. Kjo do të thotë se unë hyj në statusin e sanksionit të WorkFirst (puna së pari). Në rast se do të vihet sanksion kundër meje, kjo do të thotë:
  - Granti im do të ulet 40% ose do të zbritet pjesa e një personi, cilado që të jetë më e madhe.
  - Për të hequr sanksionin, unë duhet të ndjek planin e detyrave të mia individuale (IRP) për katër javë rresht.
  - Sapo të kryej atë që më kërkohet për katër javë rresht, dënimi im me sanksion do të hiqet duke filluar nga dita e parë e muajit pas katër javëve të sanksionit.
  - Paneli për rishikimin e sanksioneve do të rishikojë rastin tim dhe mund ta mbyllë atë po qe se unë qëndroj në sanksion për gjashtë muaj radhazi.
    - Në rast se çështja ime mbyllet nga paneli për rishikimin e rasteve, unë duhet të bëj përsëri kërkesë dhe të marr pjesë për katër javë rresht përpara se të më jepen paratë.
    - Në rast se çështja ime sanksionohet përsëri, bordi i rishikimit të sanksioneve do ta rishikojë atë dhe mund edhe ta mbyllë çështjen time nëse unë qëndroj në sanksion për tre muaj me radhë.
- Unë duhet të bashkëpunoj me Seksionin e Ndihmës për Fëmijët (Division of Child Support) ndërkohë që marr ndihmën TANF/SFA po qe se nuk kam ndonjë arsye të fortë për të mos pranuar bashkëpunimin. Marrja e rregullt e ndihmës për fëmijën mund plotësojë nevojat e mia për ndihmën në të holla.
- Unë mund të përfitoj ndihmë në të holla nga TANF/SFA vetëm për 60 muaj gjatë jetës time, po qe se nuk kualifikohem për zgjatjen e kësaj periudhe kohore.
- Unë kam përdorur _____ muaj të ndihmës në të holla.
- Mua më duhet të punoj, të kërkoj punë, ose të përgatitem të punoj me kohë të plotë për të paktën 32 orë në javë.
- Në rast se nuk marr pjesë në një aktivitet të planifikuar, unë do të lajmëroj me telefon personin në numrin e dhënë më poshtë.
- Unë duhet të kryej aktivitetet e mëposhtme çdo javë për një numër orësh të përcaktuar më poshtë:

Në rast se kam ndonjë arsye të fortë që të mos e ndjek dot planin, unë duhet të kontaktoj dhe të punoj me specialistin/punonjësin social të programit WorkFirst sa më shpejt të jetë e mundur. Disa nga arsyet e forta përfshijnë:

- Nuk munda të shkoj në takim sepse isha sëmurë ose se papritur nuk gjeta njeri që të kujdesej për fëmijën ose nuk arrita të siguroj transport;
- Unë kam një rast urgjent (fizik, mendor, ose emocional);
- Jam viktimë e dhunës në familje;
- Nuk mund të gjej një njeri të saktë që të mund ta paguaj aq sa kam mundësi për t'u kujdesur për fëmijët nën 13 vjeç;
- Kam një problem ligjor urgjent;
- Unë jam i/e paaftë ose në gjendje të tillë shëndetësore që nuk më lejon të plotësoj kërkesat e programit; ose
- Jam një person me invaliditet të rëndë ose kronik;
- Duhet të përkujdesem në shtëpi për fëmijën me nevoja të veçanta ose një të rritur me aftësi të kufizuar;
- Jam mbi 55 vjeç ose më shumë dhe kujdesem për një fëmijë megjithëse nuk jam prindi i fëmijës: ose
- Po aplikoj për SSI me anë të një ndihmësi të DSHS.

Në rast se nuk jam dakord me këtë plan, kam të drejtën të kërkoj rishikimin dhe/ose ballafaqimin për rastin tim. Për të kërkuar një ballafaqim, duhet të kontaktoj zyrën e shërbimeve në komunitet (Community Services Office) ose zyrën e ballafaqimeve administrative (Office of Administrative Hearings, DSHS, PO Box 42488, Olympia WA 98504-2488), brenda 90 ditëve nga data që menaxherja e rastit tim ve firmën këtu poshtë. Më është dhënë një kopje e planit të detyrave të mia individuale.

FIRMA E MENAXHERES SË RASTITI	DATA	FIRMA IME	DATA

JAS ID	CASE NUMBER	CLIENT ID

KËRKESA KONFIDENCIALE

Unë mund të përfitoj nga shërbimet ndihmëse për të ecur përpara në punën time, të ruaj punën, të pranoj një punë, të kërkoj punë ose të ndjek planin tim. Në rast se nuk jam dakord me një nga vendimet e shërbimeve ndihmëse, unë kam të drejtën të kërkoj rishikimin e rastit tim dhe/ose një ballafaqim. Unë do t'i kërkoj specialistit/punonjësit social të programit WorkFirst në rast se do të kem nevojë për shërbime të tilla ndihmëse si:

- Riparim makine
- Veshje
- Këshillim
- Pampera për bebet
- Shpenzime për shkollën
- Sende të higjienës personale
- Licencë/tarifa
- Prerje flokësh
- Bileta autobusi
- Pagesa për miljet
- Vegla pune
- Planifikim familjar

Gjatë kohës së sanksionit, mua nuk më sigurohen shërbimet ndihmëse (si të holla për veshje pune ose transport) derisa të filloj të marr përsëri IRP.

E kuptoj se, në rast se nuk pranoj të bashkëpunoj me Seksionin e Ndihmës për Fëmijët (Division of Child Support (DCS)), pa një arsye të fortë, granti im mund të ulet. Në arsyet e forta futet kërcënimi ndaj meje dhe fëmijëve të mi. E kuptoj se ndërkohë që marr ndihmën TANF, ndihma që merret për fëmijët mbahet për t'ia kthyer përsëri shtetit.

Kur të mos marr më TANF/SFA, DCS do të marrë ndihmën për fëmijën dhe pastaj do të ma dërgojë mua po qe se unë nuk ju kërkoj atyre për të mos e bërë këtë. Unë i kuptoj shërbimet ndihmëse, sanksionet si dhe ndihmën për fëmijën.

FIRMA E MANAXHERIT TË RASTIT	DATA	FIRMA IME	DATA